



Plani i Bashkimit të Grupit ISP për Shqipërinë ISP Albania – Veneto Banka

Shqipëri

Datë: 04 Maj 2018

INDEKSI

01 Arsyetimi në mbështetje të bashkimit

02 Marrëveshja e Bashkimit

03 Ndikimi tek punonjësit

■ Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a – historiku

- Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a ("ISP Albania") u krijua në 2008 si rezultat i bashkimit të dy bankave vendase, Bankës Amerikane të Shqipërisë dhe Bankës Italo-Shqiptare, të dyja të blera nga Grupi Intesa Sanpaolo. BASH u themelua në shtator të vitit 1998 nga Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve (AAEF), një fond investimi privat i themeluar nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara. Në dhjetor 2006, AAEF nënshkroi Marrëveshjen për Shitblerjen e Aksioneve dhe një Marrëveshje Aksionere për shitjen e BASH Grupit Intesa Sanpaolo; marrëveshja u finalizua më 29 qershor 2007. Banka e Italo-Shqiptare u themelua në korrik të vitit 1993 si një nga bankat e para private në Shqipëri dhe si një sipërmarrje e përbashkët midis Bankës Kombëtare Tregtare të Shqipërisë (në pronësi të Ministrisë së Financave) dhe Bancës Italiane të Romës (Italian Banca di Roma). Më 7 dhjetor 2005, Sanpaolo IMI nënshkroi marrëveshjen për blerjen e 80% të aksioneve të Bankës Italo Shqiptare - Banca Italo Albanese, nga Capitalia dhe Ministria e Financave (40% secila). Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (20%) ruajti pjesën e saj të aksioneve. Në vitin 2011 Grupi Intesa Sanpaolo bleu nga BERZH pjesëmarrjen e mbetur në aksione në Bankë, duke u bërë aksioneri i vetëm.

■ Veneto Banka sh.a - historiku

- Veneto Banka sh.a ("VB Albania") u themelua në vitin 2005 pas blerjes të 100% të aksioneve të Bankës Dardania nga familja Mariano, duke u bërë kështu banka e parë në Shqipëri me aksioner tërësisht italian. Në vitin 2008, Banka u bë pjesë e Grupit Veneto Banca, i cili bleu 100% të aksioneve.

- 26 qershor 2017: Pas likuidimit të detyrueshëm administrativ të Veneto Banca në Itali, Intesa Sanpaolo SpA bleu disa aktive, detyrime dhe marrëdhënie juridike të Veneto Banca, duke përfshirë, ndër të tjera, Veneto Banka sh.a.
 - **Aksionet Veneto Banca në Veneto Banka Sh.a iu shitën ISP-së, në pritje të kërkesës për autorizim që u paraqit në Bankën e Shqipërisë në bazë të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë".**
 - Me vendimin e tij nr.63, datë 01/11/2017, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë dha miratimin paraprak për blerjen e **100% të kapitalit aksioner të Veneto Banka Sh.a. nga ISP SpA.**
 - Në datën 01/12/2017 u realizua regjistrimi i transferimit të aksioneve të Veneto Banka Sh.a në ISP SpA në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

- Pas blerjes, Grupi ISP ka vlerësuar mundësitë alternative për racionalizimin e pranisë së saj në vend, duke marrë në konsideratë:
 - Qëndrueshmërinë dhe përfitueshmërinë aktuale dhe të ardhshme të veprimtarisë së biznesit të dy subjekteve,
 - Efikasitetin e procedurave për shitjen dhe likuidimin e mundshëm të një subjekti,
 - Ndikimi reputacional të çdo zgjidhjeje të mundshme.

- Siç është konfirmuar dhe në vendimin e Këshillit Drejtues të ISP-së më 4 prill 2018, u arrit në konkluzionin se bashkimi i Veneto Banka sh.a me Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a është zgjidhja më e mirë për arsyet e mëposhtme:
 - Ecuria e ISBA-s është mjaft e mirë mbi nivelin mesatar të sektorit bankar për pjesën më të madhe të treguesve, me mundësi për të përmirësuar pjesën e tregut për kreditë dhe depozitat në të ardhme;
 - Veneto Banka ka regjistruar vazhdimisht një fitim negativ gjatë viteve të fundit (kryesisht për shkak të zhvlerësimit neto të ekspozimeve të kredisë) dhe ka ndaluar pothuajse çdo kredidhënie gjatë 12-18 muajt e fundit. Nga ana tjetër, pas integritit disa potenciale komerciale mbeten për tu zhvilluar;
 - integrimi do të ruajë marrëdhëniet e biznesit me klientët ekzistues dhe do të kontribuojë në rritjen e pjesës së tregut dhe volumit të biznesit të Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a, duke e lejuar Grupin të zvogëlojë kostot e përgjithshme operative që rrjedhin nga pasja e dy strukturave operative të ngjashme në të njëjtin vend.
 - përgjatë procesit të integritit do të nevojiten investime kapitale për të garantuar respektimin e kërkesave të detyrueshme, për të siguruar një qeverisje dhe administrim të shëndoshë të riskut dhe për të lejuar klientët e ish VB Sh.a që të operojnë në sistemet dhe rrjetin ISP Albania menjëherë pas bashkimit të dy bankave.
- Integrimi do të zbatohet nëpërmjet bashkimit të Veneto Banka Sh.a me Intesa Sanpaolo Banka Albania, bazuar në qasjen e kontabilitetit të «bashkimit të interesave», duke qenë se të dyja kompanitë janë nën kontrollin e përbashkët të të njëjtit aksioner të vetëm. Nuk do të ndodh emetim të aksioneve të reja, duke pasur parasysh se kapitali neto i VB sh.a do të inkorporohet në ISBA si Rezervë e Kapitalit. Në kuadrin e inkorporimit, kapitali aksioner aktual i VB Sh.a, i shprehur në Euro, do të konvertohet në lekë.
- Procesi i integritit, në varësi të miratimit të Autoriteteve Kompetente, do të menaxhohet me qëllimin për të përfunduar brenda datës 30/09/2018.

INDEKSI

01 Arsyetimi në mbështetje të bashkimit

02 Marrëveshja e Bashkimit

03 Ndikimi tek punonjësit

- Marrëveshja e Bashkimit në lidhje me bashkimin e VB Albania me ISP Albania e cila u miratua nga Asambletë përkatëse të Aksionerëve parashikon, ndër të tjera:
 - Në zbatim të nenit 220 të Ligjit për Shoqëritë, VB Albania (“Kompania e përthithur”) do të transferojë nëpërmjet bashkimit tërësisht të gjitha aktivet dhe detyrimet e saj dhe ekzistenca më vete e VB Albania do të përfundojë. ISP Albania do të jetë Kompania Përthithëse dhe do të vazhdojë ekzistencën e saj si korporatë nën emrin e saj: "INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA" SHA.
 - Duke qenë një bashkim midis dy bankave në pronësi të plotë të të njëjtit aksioner, kapitali i regjistruar i ISP Albania nuk do të zmadhohet pas bashkimit, prandaj është e nevojshme që të përcaktohet raporti i këmbimit të aksioneve, shuma e çdo pagese në mjete monetare cash ose kushtet e ndarjes së aksioneve në Kompaninë Përthithëse.
 - Tërësia e aktiveve dhe detyrimeve të VB Albania, të cilat do të transferohen tek ISP Albania do të bazohen në bilancin e audituar të VB Albania dhe ISP Albania më 31st Dhjetor 2017. ISP Albania do të aplikojë opsionin për konsolidimin retrospektiv, prandaj bilanci i parë pas bashkimit të ISP Albania do të paraqitet si rezultat i inkorporimit të njëkohshëm të bilancit dhe gjendjes së pasqyrës së të ardhurave të VB Albania në ISBA duke filluar nga data 01/01/2018.
 - Efektive në datën e mbylljes, ISP Albania do të jetë pasardhësi, nëpërmjet bashkimit me përthithje, të VB Albania në çdo dhe të gjitha kontratat, aktet dhe marrëdhëniet në të cilat VB Albania është palë, qoftë ekzistuese ose në të ardhmen. Rrjedhimisht, të gjitha aktivet dhe detyrimet, duke përfshirë të gjitha aktivet materiale dhe jomateriale, të gjitha tepricat kreditore tatimore, si dhe të gjitha pronat e paluajtshme, marrëdhëniet kontraktuale dhe marrëdhënie të tjera juridike dhe pozicione juridike të çfarëdo lloji, të arkëtueshmet dhe detyrimet, detyrimet potenciale dhe të ardhurat e ardhshme dhe të kushtëzuara të VB Albania, do të transferohen tek ISP Albania.
 - Statuti ekzistues i **ISP Albania** do të jetë Statuti i Kompanisë Përthithëse.

INDEKSI

01 Arsyetimi në mbështetje të bashkimit

02 Marrëveshja e Bashkimit

03 Ndikimi tek punonjësit

- Marrëveshja e Bashkimit e parashikuar për subjekteve që janë subjekt bashkimi ISP Albania dhe VB sh.a dhe miratuar nga Asambletë përkatëse të Aksionerëve përcakton sa më poshtë, në lidhje me ndikimin tek punonjësit e kompanive që janë subjekt bashkimi:
 - Pasojat e Bashkimit për punonjësit e VB Shqipëri do të burojnë në bazë të neneve 138, 139 dhe 139/1 të Kodit të Punës.
 - Në Datën e Mbylljes, të gjitha kontratat e punës ku VB Albania është pjesëmarrësi si palë në atë kohë, do t'i transferohen në bazë të ligjit ISP Albania, e cila do të vazhdojë kontratat e punës të punonjësve të transferuar së bashku me të gjitha të drejtat dhe detyrimet.
 - Kontratat kolektive të VB Albania, nëse ka, do të zëvendësohen nga kontrata kolektive të ISP Albania.
 - ISP Albania do të jetë përgjegjëse për çdo dhe të gjitha detyrimet, përfshirë detyrimet e papaguara – që burojnë nga kontratat e transferuara të punës.
- Përveç sa më sipër dhe sikundër përcaktohet në mënyrë të detajuar në Planin e Biznesit që u paraqit për miratim në Asambletë e Aksionerëve të subjekteve që po bashkohen
 - Racionalizimi i fuqisë punëtore të agreguar, si pasojë e ristrukturimit të bankave që rezulton nga bashkimi, do të menaxhohet në përputhje me ligjin e punës të vendit, duke garantuar aftësinë e të dy bankave për të përmbushur vazhdimisht dhe deri në përfundimin e procesit të bashkimit aktivitetet e detyrueshme ndaj të gjithë grupeve të interesit dhe duke marrë në konsideratë ngarkesën e punës shtesë për funksionet të caktuara të bankës përthithëse nga blerja e portofoleve shtesë të klientëve, kontratave dhe produkteve.
 - Bashkimi i dy bankave do të kërkojë zbatimin e një plani ristrukturimi. Banka do të menaxhojë një plan të tillë ristrukturimi, vetëm për arsye ekonomike, teknike ose strukturore, në përputhje të plotë me ligjet në fuqi në Shqipëri. Veçanërisht (i) rretet fizike të të dy Bankave paraqesin një mbivendosje të konsiderueshme dhe bazohen në një model dhe profil të ngjashëm biznesi; (ii) drejtoritë qendrore paraqesin pothuajse të njëjtin konfigurim; (iii) gjendja financiare e Veneto Banka sh.a. konfirmon një profitabilitet strukturor negativ që do të sillte një barrë ekonomike të paqëndrueshme për subjektin e ri; (iv) ka dublikime të dukshme të sistemeve, faciliteteve, si dhe të burimeve të tjera fizike dhe njerëzore. Rrjedhimisht, sa i përket ndikimit tek punonjësit, ky plan ristrukturimi do të menaxhohet në përputhje të plotë me nenin 138 të Ligjit Shqiptar të Punës i cili lejon të vazhdohet me një plan për shkurtimin kolektiv të punonjësve.
 - Nga 115 punonjës të VB sh.a më 31/03/2018, 37 persona do të vazhdojnë të jenë pjesë e Grupit, ndërsa 78 të tjerët do të jenë subjekt i një "Plani Shkurtimi Kolektiv ", zbatimi i të cilit do të realizohet menjëherë pas miratimit të Planit të Bashkimit nga autoritetet kompetente.